



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. 209/3 Prot.

Pogradec, më 16.01. 2025

**Lënda :** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**ZNJ.MANJOLA KAMOLLI**  
**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**I nderuar Zoti Kryetar ,**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues , :  
**PER MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË**  
**TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-**  
**NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2025.**

Me respect,

**KRYETARI**

**Ilir XHAKOLLI**



Nr.i faqeve A4 të project-vendimit : 1

Nr.i faqeve A4 të relacionit shoqërues : 2



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**  
**KËSHILLI**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**PROJEKT- VENDIM**

Nr. \_\_\_\_, Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2025

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2025.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, 1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", ndryshuar me Vendimin nr.855, datë 26.12.2024 :

**KËSHILLI I BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, për vitin 2025.

Përfituesit nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike do të përzgjidhen nga familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat janë refuzuar nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike pasi kanë marrë pikë të pamjaftueshme, pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme për të jetuar dhe plotësojnë këto kriterë:

1. Të përfitojnë familjet me më shumë se dy fëmijë që refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme, me nevoja sociale të theksuara dhe nuk kanë asnjë anëtar të punësuar.
2. Kryefamiljaret gra, të cilat refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme .
3. Te moshuarit të mbetur vetëm që janë në varfëri ekstreme dhe refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme .
4. Beqarët të ngelur vetëm , në moshë mbi 40 vjet , të pamundur për të punuar të cilët janë refuzuar nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike për pikë të pamjaftueshme, pa të ardhura,
5. Familje që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuar , refuzuar nga sistemi për pikë të pamjaftueshme dhe nuk kanë asnjë të punësuar.
6. Familjarë në prag pensioni që nuk kanë mundësi punësimi dhe janë refuzuar nga sistemi për pikë të pamjaftueshme.

**KRYETAR**  
**Manjola KAMOLLI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 204/Prot.  
3

Pogradec, më 16.01 . 2025

**RELACION**

**Mbi kriteret që duhet të plotësojnë familjet përfituese nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike për vitin 2025 .**

**Projekt-vendimi për miratimin e kriterëve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri 6% nga fondi i kushtëzuar është Akt administrativ individual.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, 1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", ndryshuar me Vendimin nr.855, datë 26.12.2024, Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Pogradec ka paraqitur disa kriterë për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

Fondi që do të përdoret është 6% e fondit faktik që çelët çdo 2 muaj për përfituesit e ndihmës ekonomike të përzgjedhura nga sistemi i pikëzimit.

Familjet në nevojë përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit për pikë të pamjaftueshme. Prioritet do të kenë familjet me nevoja social ekonomike të theksuara .

Njësitë Administrative bëjnë rekomandimin në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike familjet që plotësojnë kriteret për të përfituar nga Fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike . Struktura përgjegjëse për Shërbimet Sociale në Bashki , në bazë të propozimeve dhe vlerësimeve Social Ekonomike të ardhura nga njësitë administrative për trajtim me ndihmë ekonomike ,shqyrton , vlerëson dosjet sipas kriterëve ,procedurave dhe sistemit të pikëzimit ,si dhe harton projekt-vendimin për familjet në nevojë nën juridiksionin e Bashkisë .

Përlllogaritjet e masës së ndihmës bëhen automatikisht nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike , dhe është e njëjtë me masën e ndihmës ekonomike të përfituesve nga sistemi.

Dokumentacioni mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, është si më poshtë;

a. Vlerësimi Social Ekonomik.

b. Fletë përmbledhje e daljes nga sistemi i pikëzimit.

c.Vërtetim i KMCAP për familjet që kanë në përbërje PAK ose invalid pune.

d.Fotokopje e kartës së identitetit.

e.kontrata e energjisë për të përfituar kompesim energjie.

Konceptoi: Luljeta Mançellari

Miratoi: Ivana Capollari

Jurist : Klevisa Liçkollari

Konfirmoi: Dritan Babasuli



**KRYETAR**  
**Illir Xhakolli**